



**Prishtinë: 30.09.2011**

**Kodi i ZRRE-së: V\_370\_2011**

**Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_618\_06\_11**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_618\_06\_11**;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 18.07.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2011 nxori këtë:**

#### **VENDIM**

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Musa Shabani nga Ferizaj (shifra e konsumatorit DFE – 13351) si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

#### **Arsyetim**

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 03.06.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 26.02.2010 lidhur me kontestimin e njoftimit për shkyçje dhe shkyçjes.

- Me datë 15.03.2004 punëtorët e autorizuar të KEK kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 5518494 dhe kanë vendosur njehsorin nr. 31977401.  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrike nr. 13351 të datës 15.03.2004
- Me datë 28.04.2008 punëtorët e autorizuar të KEK kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 5518494 dhe kanë vendosur njehsorin nr. 31977401.  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrike nr. 003772 të datës 28.04.2008
- Me datë 28.04.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë konstatuar se konsumatori ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, njehsori elektrik është vulosur dhe se njehsori elektrik të rregullt.  
**Provë:** Procesverbali nr. 067493 i datës 28.04.2008
- Në periudhën 04/2008 KEK-u i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike me shpenzim prej 41801 kWh, apo e shprehur financiarisht në vlerë prej 2650.00 €. **Provë:** Fatura e KEK-ut e muajit 04/2008
- Me datë 18.07.2008 KEK-u ka lëshuar një Urdhër Lejimin / Ngarkimin nr. 8355 në shifrën DFE – 13351 duke bërë një korigjim në vlerë prej 293.52 €, në arsyetimin se zbritet ndryshimi i çmimit tarifor për muajin 04/2008 për shkak të leximit jo të rregullt të njehsorit elektrik, ku harxhimi i këtij muaji llogaritet 50%me çmim verë-dimër sipas procesit nr. 003772 të datës 28.04.2008.  
**Provë:** Urdhër lejimi ngarkimi nr. 8355 të datës 18.07.2008



- Me datë 05.08.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK, duke kundërshtuar faturën e muajit 04/2008.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit
- Me datë 26.02.2010 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorin duke e aprovuar pjesërisht.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datë 26.02.2010
- Me datë 03.06.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 30.06.2011 DMK ka lëshuar një vendim duke refuzuar ankesën e konsumatorit dhe duke ardhur në përfundim se:
  1. KEK-u ka gabuar në mos faturimin e konsumatorit DFE – 13351 me shpenzimet mujore të energjisë elektrike e të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 31977401 nga data 15.03.2004 dhe se kjo është neglizhencë e punëtorëve të KEK-ut, por kjo nuk e përjashton konsumatorin nga pagesa për shpenzimin e krijuar.
  2. Konsumatori ka bërë shpenzimin e energjisë elektrike prej 41,801 kWh për 49 muaj (prej datës 15.03.204 e deri te periudha 28.04.2008) dhe se ky shpenzim është i regjistruar në njehsorin elektrik nr. 31977401.
  3. KEK-u duhet të bëjë shpërndarjen e kilovatëve të grumbulluar në mënyrë proporcionale prej periudhës 03/2004 – 04/2008.
  4. KEK-u për shkak të neglizhencës së tyre duhet të ofrojnë konsumatorit një kontratë pagese me 49 këste mujore për të paguar faturën 04/2008.
- Me datë 18.07.2011 konsumatori ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_618\_06\_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: **ZRRE/DMK\_V\_618\_06\_11** të mbetet në fuqi.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar